

**VENDIM**  
**Nr. 544, datë 27.7.2016**

**PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË BRIGJEVE NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË  
PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK “GREEN COAST”<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM nr.394, datë 3.5.2017)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “Green Coast”, Palasë, Himarë, zona kadastrale 1481–1739, i cili ka përfituar statusin e investimit strategjik, procedurë e veçantë, me vendimin nr.2/13, datë 14.7.2016, të Komitetit të Investimeve Strategjike.

2. Afati për përdorimin e brigjeve sipas këtij vendimi të jetë 20 (njëzet) vite duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

*2.1 Bashkia Himarë ka detyrimin që brenda 15 ditëve, nga data e paraqitjes së kërkesës së investitorit strategjik “Green Coast”, të lidhin kontratën përkatëse për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit, në përputhje me sipërfaqet dhe destinacionin e kërkuar nga subjekti, brenda koordinatave të sipërfaqes së lejuar nga vendimi i KIS-it.*

*2.2 Së bashku me kërkesën, investitori strategjik “Green Coast” duhet të paraqesë pranë Bashkisë Himarë edhe dokumentacionin e mëposhtëm:*

- *Ekstrakt të 3 muajve të fundit nga Qendra Kombëtare e Biznesit;*
- *Planvendosje të sipërfaqes, për të cilën subjekti kërkon të lidhë kontratë me njësinë e vetëqeverisjes vendore;*
- *Përshtetjet të aktivitetit që do të realizojë në sipërfaqen për të cilën kërkon të lidhë kontratë.*

3. Përdorimi i brigjeve do të kryhet përgjatë periudhës së sezonit veror, 15 maj - 30 shtator të çdo viti, përkundrejt pagesës së tarifës, në përputhje me tarifën e plazheve, të përcaktuara në vendimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Himarë. Kjo tarifë do të aplikohet vetëm mbi sipërfaqen objekt kontrate, sipas pikave 2.1 dhe 2.2, më sipër, të lidhur me Bashkinë Himarë, përgjatë periudhës së përmendur në këtë pikë.

4. Të ardhurat e mbledhura nga tarifa për dhënien e së drejtës së përdorimit të brigjeve administrohen dhe bëjnë pjesë në buxhetin e Bashkisë Himarë.

5. E drejta e përdorimit të brigjeve nga ana e investitorit strategjik “Green Coast”, me NIPT/NUIS: L41329038D, koordinatat, sipërfaqja e lejuar për përdorim afatgjatë dhe kushtet e përdorimit bazohen në përcaktimet e bëra në vendimin nr.2/13, datë 14.7.2016, të Komitetit të Investimeve Strategjike, dhe në përcaktimet e kontratës përkatëse që investitori strategjik duhet të lidhë me Bashkinë Himarë.

6. Ngarkohet Bashkia Himarë për lidhjen e kontratës përkatëse me investitorin strategjik në zbatim të këtij vendimi. Në këtë kontratë parashikohen shprehimisht të drejtat e detyrimit e autoritetit kontraktues dhe të drejtat e detyrimit e investitorit, në funksion të projektit të investimit strategjik.

7. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

---

<sup>1</sup> VKM nr.544, datë 27.7.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.145, datë 3 gusht 2014.  
VKM nr.398, datë 3.5.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.106, datë 11 maj 2017.